



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË  
PROCESVERBAL

Nr. 258/Prot.

Tiranë, më 11.11.2020

Sot, më datë 11.11.2020, ditën e mërkurë, ora 11.00, Këshilli i Lartë i Prokurorisë zhvilloi një mbledhje plenare jashtë radhës, thirrur nga Kryetari, bazuar në nenet 164 deri 167 të Ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Këshilli u mbledh në prani të anëtarëve si më poshtë:

1. Z. Gent Ibrahim
2. Z. Alfred Balla
3. Znj. Esmeralda Keshi
4. Z. Tartar Bazaj
5. Z. Bujar Sheshi
6. Z. Sandër Beci
7. Znj. Nurihan Seiti

Mbledhja u zhvillua nën drejtimin e Kryetarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, z. Gent Ibrahim, i cili, në zbatim të nenit 166 të Ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, pasi verifikoi pjesëmarrjen e anëtarëve, bëri hapjen e saj në kushtet e kuorumit dhe kaloi në paraqitjen e rendit të ditës.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i projektvendimit “Për caktimin e përkohshëm në pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë”.



**Z. Ibrahim** sqaron se kjo mbledhje zhvillohet në kushte urgjente për shkak të gjendjes shëndetësore të drejtuesit të përkohshëm të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, i cili e ka të pamundur të ndjekë normalisht proceset gjyqësore. Në mënyrë që të sigurohet në vazhdimësi funksionaliteti i kësaj prokurorie, është e nevojshme që të bëhet një caktim i përkohshëm në këtë pozicion. Fton z. Beci të relatojë.

**Z. Beci** relaton se Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në datë 08.07.2019 ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë. Në këto kushte, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, me qëllim plotësimin e vendit të lirë përkohësisht të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, në vijim të disa caktimeve të përkohshme, së fundmi me Vendimin Nr. 221, datë 15.10.2020 ka caktuar përkohësisht z. Gjon Fusha të ushtrojë funksionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë për periudhën nga data 16.10.2020 - 15.01.2021.

Për shkak të gjendjes shëndetësore (infektim me virusin COVID 19), z. Gjon Fusha, i caktuar përkohësisht në pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, e ka të pamundur të paraqitet në punë dhe të ndjekë proceset gjyqësore, gjë e cila sjell vështirësi në funksionimin e prokurorisë, pasi ai aktualisht është prokurori i vetëm në atë prokurori apeli.

Në këtë situatë del e nevojshme caktimi i përkohshëm i drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë. Komisioni Zhvillimit të Karrierës ka evidentuar si kandidat z. Henrik Haxhiraj, aktualisht prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, i cili ushtron detyrën si prokuror, fillimisht në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rethit Gjyqësor Vlorë, që nga data 01.09.1989. Më pas, në datën 01.03.1998 është emëruar prokuror në Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, ku vazhdon të ushtrojë detyrën e prokurorit.

Sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, bazuar në Rregulloren “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve”, si dhe pasi bëri verifikimet përkatëse pranë zyrës së burimeve njerëzore, propozon që prokurori Henrik Haxhiraj të caktohet përkohësisht të ushtrojë funksionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë për një afat një mujor, nga data 11.11.2020 - 10.12.2020, pasi plotëson kushtet e përcaktuara në ligj dhe në Rregulloren e lartpërmendur.



Duke qenë se nuk ka pyetje dhe komente të mëtejshme, **Z. Ibrahimi** vijon me leximin e projektvendimit dhe e hedh atë në votim.

**Të gjithë janë dakord. Miratohet me 7 vota pro.**

*(Vendimi i plotë gjendet i publikuar në faqen zyrtare të Këshillit).*

**Z. Ibrahimi** falënderon anëtarët për diskutimet e tyre dhe në përfundim, duke mos patur pika të tjera për diskutim, e deklaroi mbledhjen të mbyllur.

**Mbajtësi i procesverbalit**

**Frederik Sulisufi**



**KRYETARI**

**Gent Ibrahimi**

**Shënim 1:**

Në këtë procesverbal ~~janë~~ nuk janë vënë në dukje pasaktësitë e mundshme, të konstatuara nga anëtarët e KLP-së.

Pasaktësitë e vërejtura janë reflektuar me urdhër të kryetarit Nr. \_\_\_ Datë \_\_\_ 2020/me vendim të Këshillit të Lartë të Prokurorisë Nr. \_\_\_ datë \_\_\_ (bashkëlidhur kopjet e dokumenteve).

Procesverbali i mësipërm u miratua në mbledhjen e radhës të KLP-së, datë 23/11/2020  
Procesverbali të arkivohet.

**Shënim 2:**

Për arsye teknike, kjo seancë nuk është e regjistruar në audio dhe përmbajtja e saj pasqyrohet vetëm në këtë procesverbal.

**PËRGJEGJËSI I SEKTORIT TË SHËRBIMEVE ADMINISTRATIVE**

**Frederik Sulisufi**

